



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2022:087816

Datë: 07.08.2024

Numri i dokumentit: 06029444

**P.nr.117/22**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.31/24 të datës 07.08.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurve: B. L, S. B dhe A. T, që të tre nga Hani Elezit dhe të dëmtuarit A. M nga fsh....-Skenderaj, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.605/22 të 27.04.2022 për shkak të veprës penale, Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 07.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.31/24 të datës 07.08.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurve: B. L, S. B. dhe A. T., që të tre nga Hani Elezit dhe të dëmtuarit A. M. nga fsh....-Skenderaj.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.605/22 e datës 27.04.2022 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurve:

**1. B. L.** nga Hani Elezit, rr.”...” pn, i lindur me datë ..., nga i ati I... dhe e ëma S..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës, me nr. personal: ...

**2. S. B.** nga Hani Elezit, rr.”...” pn, i lindur me datë ..., nga i ati I... dhe e ëma N..., e gjinisë I..., shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës, me nr. personal: ...

**3. A.T.** nga Hani Elezit, rr.”...” pn, i lindur me datë ..., nga i ati Z... dhe e ëma G..., e gjinisë K..., shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës, me nr. personal: ...,

- për shkak të veprës penale në bashkryerje, Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.605/22 e 27.04.2022, i ka akuzuar të pandehurit: B. L., S. B. dhe A. T., që të tre nga Hani Elezit, për shkak të veprës penale në bashkryerje, Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.08.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si P.nr.117/22 , të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 07.08.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit te kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.31/24, në mes palëve në procedurë dhe ate të pandehurve: B.L., S.B.dhe A.T., që të tre nga Hani Elezit dhe të dëmtuarit A. M. nga fsh.....-Skenderaj.

Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEGA KAÇANIK**

**P.nr.117/22 datë, 07.08.2024**

Sekretarja Juridike  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.